



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo – Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VI**

**Sesioni vjeshtor**

**Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr.36

Prishtinë, më 03 tetor 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**Procesverbal**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj dhe Albert Kinolli.

Munguan: Valon Ramadani, Adem Mikullovi, Imet Rrahmani, Arban Abrashi dhe Milaim Zeka.

Në mbledhje morën pjesë përfaqësuesit e Zyrës së BE-së, OSBE, KDI-së, IKD, RTK, KTV, Ekonomia online, D+ dhe Koha Ditore.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-111, për Pagat në Sektorin Publik;**
3. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 06/L-113, për Organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura;**
4. **Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr.06/L-114, për Zyrtarët Publik;**
5. **Të ndryshme.**

**Nait Hasani** i njoftoi se komisioni vazhdon me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës nga mbledhja e kaluar, për të vazhduar pastaj me rendin e ditës të sipërsënuar.

Ai u propozoi anëtarëve të komisionit miratimin në parim të P/ligjit për transmetuesin publik.

**Shqipe Pantina** propozoi, që të merret parasysh kërkesa e opozitës, që Projektligji për RTK-në të procedohet për miratim në parim pas dy javësh në mënyrë që gjatë kësaj kohe të shqyrtohen

vërejtjet dhe propozimet e adresuara nga institucionet e tjera dhe grupet e interesit. Kjo është arsyeja që në mbledhje mungon opozita.

Kërkesa e saj ishte, që të shtyhet P/ligji për transmetuesin publik të paktën edhe për dy javë, të mos bllokohet punën me ligjet e tjera dhe për hir të ruajtjes së bashkëpunimit pozitë-opozitë.

**Nait Hasani** tha se në takimin joformal të anëtarëve të komisionit, këta të fundit janë dakorduar që në këtë takim të diskutohet edhe Projektligji për transmetuesin publik.

**Xhevahire Izmaku** tha se mungesa e opozitës është e pajustificueshme, sepse ata kanë mund të marrin pjesë dhe të prezantojnë kërkesën e tyre, por jo edhe ta bojkotojnë procedimin e çështjeve që komisioni ka në rend dite për shqyrtim e miratim.

**Albert Kinolli** tha se janë mbajtur tri takime lidhur me rendin e ditës. Bojkoti nuk është mënyrë e zgjidhjes së problemit dhe nuk është e arsyeshme që dikush të bëhet avokat i opozitës.

**Nait Hasani** propozoi që projektligji të kalojë në seancë për lexim të parë, e pastaj të merren parasysh vërejtjet dhe kërkesat e grupeve të caktuara.

**Shqipe Pantina**, duke përsëritur qëndrimin e saj si pjesë e opozitës, tha se nëse kërkesa e opozitës nuk aprovohet për shtyrjen e procedimit të projektligjit, ajo nuk do të vazhdon të jetë pjesë e kuorumit.

**Konstatim:** Në mungesë të kuorumit mbledhja përfundoi deri në caktimin e mbledhjes së radhës.

Mbledhja përfundoi në orën:11:00.

**E përgatiti:**

**Stafi mbështetës i komisionit.**

**Kryetari i komisionit,**

-----  
**Nait Hasani**